

S.O.S.

Sistemi Operativ ShqipON

Një projekt për Normalizimin e Shqipërisë

DEMOKRACI + EKONOMI

punësim = zhvillim = shërbim





www.levizjashqipon.com



S.O.S. është një projekt i hapur dhe i përmirësueshëm çdo ditë.

Shqipërisë i duhen shumë reforma për kalimin në një shoqëri të begatë, demokraci funksionale dhe ekonomi të zhvilluar.

Këtu kemi jemi munduar të paraqisim vetëm shinat e përgjithshme (Demokraci+Ekonomi) ku do kalojë ky makroprojekt, i cili mbetet i hapur për kontribute të qytetarëve dhe profesionistëve të të gjitha fushave.

Hapi i parë mbetet ai politik, ose reformat për demokratizimin e vendit dhe çlirimin e ekonomisë, në mënyrë që reformat e mëtejshme të mund të zbatohen efektivisht.

ShqipON do të mbrojë integritetin dhe themelin e propozimeve S.O.S. ashtu sikundër nuk do lejojë që këto ide të vidhen, të deformohen apo të zbatohen në mënyrë hibride, prej aktorëve të këtij sistemi banal dhe antikombëtar, si ka ndodhur rëndom këto 25 vite tranzicion.

A perspective view of a railway track receding into a dark tunnel. The tracks are illuminated by a bright light at the far end, creating a strong sense of depth and direction. The tunnel walls are dark and arched, with the light source creating a bright glow at the horizon.

#NukEshteVone



www.levizjashqipon.com



Përmbledhje	6
Hyrje	7
Shina e parë - Demokracia	16
Modifikim i Kushtetutës me Referendum	18
Parashikimi i referendumeve me detyrim dhe fakultativ	18
Aprovimi i ligjit patriotik për "karantinë" të detyruar ndaj ish zyrtarëve të lartë	19
Konstitucionalizimi i partive politike.	20
Zgjedhje e drejtpërdrejtë nga qytetarët të zyrtarëve të lartë të Republikës.	21
Rishikimi popullor (<i>recall</i>).	26
Vota për emigrantët dhe krijimi i një nëndhome parlamentare të diasporës	26
Vetëm dy mandate për zyrtarët e lartë shtetërorë	26
Juritë qytetare	27
Riformatim i sistemit të Drejtësisë	28
Reforma të tjera	29
Shina e dytë - Ekonomia	34
Punësimi	38
Platforma ekonomike Shqipëri - Kosovë	39
Zhvillimi i Bankave Komunitare	47
Krijimi i bursës	48
Bujqësia dhe Prona	51
Gjenocidi enverist.	52
Edukimi dhe arsimi.	53
Shëndetësia	55
Krijimi i një qyteti komunitar	60
Krijimi i class action	62
Mbrojtja e veçantë e artit, sportit dhe trashëgimisë kulturore	62
Konstitucionalizimi i Medias	62
Parashikimi dhe ashpërsimin tejet të fortë i veprave penale	64
Mbulimin falas të internetit mobile në çdo cep të Shqipërisë	64
Emigracioni shqiptar dhe diaspora	64
Vazhdim	67

Hyrje

ShqipON nuk është parti dhe **S.O.S.** nuk është një program elektorali!

S.O.S. është më shumë se sa një thirrje patriotike e qytetarëve të ndershëm dhe patriotë për çlirimin e vendit nga zaptuesit e demokracisë, nga monopolistët e ekonomisë dhe armiqtë e diturisë.

S.O.S. është një përpjekje serioze për të nxjerrë vendin nga kurthi 25 vjeçar ngritur nga qarqe antishqiptare të brendshme dhe të huaja dhe ndërtimin e një rrugëtimi të ri ku Shqipëria iu kthehet qytetarëve shqiptarë.

S.O.S. është një Makroprojekt inteligjent dhe realist për të shtruar shinat e zhvillimit 1) demokratik dhe 2) ekonomik të vendit. Shqipëria zotëron burime njerëzore dhe natyrore të mjaftueshme për ndërtimin e një vendi dinjitoz për qytetarët e saj.

Ndërtimi i këtij projekti të ri do të realizohet vetëm me pjesëmarrjen aktive të të gjithë shqiptarëve brenda dhe jashtë vendit. Për këtë arsye S.O.S. nuk është thjesht një program, por një sistem operativ, sepse synon ndryshimin e ADN-së, së sistemit aktual. Forca e demokracisë qëndron në aftësinë e saj për t'iu përshtatur nevojave të shoqërisë, prandaj ky projekt është konceptuar i hapur (*open source*) për përmirësime nga të gjithë qytetarët.

Një projekt **inteligjent**, sepse ndryshon perspektivën. Fitoret më të mëdha të Njerëzimit kanë ardhur pikërisht nga ndryshimi i perspektivës

për zgjidhjen e problemeve. Çfarë kuptimi ka të vazhdojmë me “*reforma demokratike dhe programe ekonomike*” kur vetë sistemi kundërshton zbatimin e tyre? Virus këtu nuk janë programet por vetë sistemi ngritur mbi antivlerat e demokracisë dhe ekonomisë së tregut, pra kundër interesave kombëtarë.

Sistemi është i bllokuar nga një kastë që prodhon privilegje për pakicën dhe varfëri për shumicën. Në këtë situatë dramatike, është iluzion të pretendosh se zgjidhja do të vijë nga sipër, sepse elita politiko-ekonomike kontrollon të gjitha kanalet dhe i bën rezistencë ndryshimit. Prandaj shqipON synon ndryshimin e kësaj perspektive, duke e hapur sistemin nga poshtë për pjesëmarrje aktive të qytetarëve si të vetmit të interesuar për funksionimin e demokracisë dhe zhvillimin e ekonomisë.

Një projekt **realist** dhe i plotë, sepse nuk e sheh zgjidhjen tek ndonjë despot i ndritur apo tek bamirësit ndërkombëtarë, por tek bashkërendimi i energjive dhe pasurive të shqiptarëve kudo që janë, për të krijuar një shoqëri të drejtë dhe të begatë, që të dijë të rritet ekonomikisht dhe shpirtërisht në harmoni me natyrën dhe me përgjegjësi për brezat që do të vijnë.

Është misioni i brezit tonë dhe e drejta e popullit sovran për të ndërtuar atë makinë shtetërore që **garanton** efektivisht pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në jetën politike dhe ekonomike të vendit. Pjesëmarrja direkte e qytetarëve në miratimin e politikave dhe kontrollin e institucioneve, është sot garancia më e mirë për realizimin e të drejtave civile, politike dhe ekonomike të parashikuara në Kushtetutë dhe akte ndërkombëtare.

Transferimi i instrumentave vendimarrës nga lart poshtë, nga partitë tek qytetarët, jo vetëm që rrit sensin e përgjegjësisë kolektive, ndërgjegjen komunitare dhe kohezionin social por dhe imunizon demokracinë nga njerëz dhe struktura që punojnë kundër saj.

Degradimi i sotëm ekonomik dhe social i vendit është vepër pikërisht e këtyre grupimeve që zaptuan institucionet duke paralizuar mekanizmat e demokracisë dhe ekonomisë së tregut.

Regjimi që u prodhua me "*heshtjen*" e aktorëve ndërkombëtarë, replikon ADN-në e diktaturës enveriste në forma dhe metoda të reja. Pushteti nuk i kaloi kurrë realisht popullit megjithë iluzionin e zgjedhjeve pa zgjidhje dhe rotacionit pa ndryshim.

Kasta u riprodhua në metastazë me parti të reja që ruanin të njëjtën ADN me të njëjtët njerëz që të lidhur me fije të dukshme dhe të padukshme do të shuanin që në filizë çdo lëvizje që mund të rrezikonte *status quo* – në e krijuar. Sistemi vijon ta bëjë vetë oponencën ndaj tij duke vjedhur hapësirën dhe simbolet për një opozitë të vërtetë.

Karikatura e demokracisë, krijuar me ndihmën edhe të qarqeve antishqiptare, duhet të diskreditonte demokracinë, si përgjegjëse për premtimet e pambajtura, prandaj e panevojshme, prandaj e zëvendësueshme. Propaganda sistematike 25 vjeçare e një medie në shërbim të kastës krijoi një kurth psikologjik tek shqiptarët që të praninin "*të keqen më të vogël*" si të vetmen zgjidhje.

Humbja e legjitimitetit të brendshëm mbi **reforma** që nuk u realizuan kurrë (*si: zhvillimi ekonomik, vendet e punës dhe shërbime publike dinjitoze; ndarja me përgjegjësit e regjimit komunist dhe hapja e dosjeve; rregullimi*

ligjor i së drejtës së pronës; demokratizimi i partive nga poshtë; krijimi i një sistemi drejtësie që garanton të drejtat dhe mundëson zhvillimin ekonomik kombëtar; transparenca e kapitalit financiar, ndarja e pushteteve; zgjidhja e çështjes kombëtare etj.) do të zëvendësohej ngadalë me forma të tjera etero-legjitimiteti. Me një legjitimitet të siguruar nga jashtë vendit gërshetuar me atë që në teorinë politike njihet si solidariteti korruptiv. Pushteti prodhoi me forcën e autoritetit, modele korruptive duke detyruar qytetarët ti pranojnë ato, si e vetmja mënyrë për të mbijetuar apo për të patur "sukses" në të gjitha fushat. Në këtë mënyrë përgjegjësjësia duket sikur shpërndahet tek të gjithë dhe askush, prandaj fajësimi i vetë popullit, prandaj sllogani "Shqipëria nuk bëhet dhe ju meritoni këtë klasë politike".

Kur vendi privohet prej forcave dhe energjive më pozitive, kur aftësia për të korruptuar dhe për të shantazhuar shndrohohet në motorrin e jetës politike dhe ekonomike të vendit, i gjithë sistemi ecën mbrapsht drejt degradimit shoqëror dhe **kolapsit** ekonomik.

Pavarësisht nevojës për një diagnozë të qartë, duhet të kuptojmë se ky nuk është një fenomen natyror por njerëzor, dhe si i tillë ka gjithmonë një **rrugëdalje**. Është detyrë e njerëzve me integritet dhe patriotë që të përgatisin këtë rrugëdalje.

Pakënaqësia sociale po akumulon çdo ditë energji të tilla, të cilat nëse nuk kanalizohen në një projekt demokratik të hapur për qytetarët, mund të çojnë vendin drejt një krize më të thellë se ato që kemi eksperimentuar këto 25 vite.

Pyetja e famshme, "**kush** do shpëtojë vendin", është antiiluministe dhe fataliste. Pyetja e duhur është: "**si** do bëhet Shqipëria"?

Popujt perëndimorë e gjetën përgjigjen tre shekuj përpara, kur hoqën dorë prej idhujve dhe vunë pushtetin nën kontrollin e qytetarëve. Vetëm një shtet në kontrollin e qytetarëve dhe jo grupimeve të errëta, do arrijë të përkujdeset aktivisht për konfigurimin e interesit publik dhe mbrojtjen e interesave ekonomike kombëtarë në erën globale.

S.O.S. mishëron pikërisht këtë rrugëdalje demokratike, sepse kërkon një shtet të kontrolluar nga qytetarët dhe jo një shtet të marrë peng nga një kastë që me anë të tij kontrollon qytetarët, ekonominë, punën, median deri tek sporti, arti dhe kultura.

Eksperiencia negative post komuniste dhe ajo pozitive e vendeve evropiane, na mëson se pa një "*proçes dezinfektimi*" ndaj të gjithë aktorëve përgjegjës të kësaj situatë, shkëputja nga e kaluara dhe ndërtimi i së ardhmes është iluzion.

Efektet e sotme të këtij sistemi korruptiv dhe radioaktiv synojnë të prekin të gjitha organet dhe të bllokojnë prodhimin e së vërtetës. Në këtë situatë, me të drejtë tek qytetarët dhe opinioni publik, është krijuar **dyshimi legjitim** i komprometimit të gjithë atyre që janë përfshirë në lojërat e sistemit. Nga ana tjetër arkitektët dhe përfituesit e këtij sistemi nuk mund të fshihen tek kjo perde tymi që vetë krijuan për të ruajtur privilegjet përjetësisht.

Nga ky kurth mund të dalim vetëm nëse krijohet një **"karantinë"** për të gjithë ata që kanë mbuluar poste të larta publike që të mos përshihen përkohësisht (4 vjet) në sistemin e ri deri sa makina e drejtësisë të vihet në punë për të zbardhur aktivitetin dhe pasuritë e tyre. Mekanizma të tillë ngritur mbi dyshimin legjitim pranohen edhe sot nga rendi juridik sepse nuk përbëjnë kufizim absolut të së drejtës. Nga ana tjetër përfshirja në administratën shtetërore, më shumë sesa e drejtë është një shërbim në dobi të interesit publik dhe kjo mundësi duhet tu jepet vazhdimisht gjithë qytetarëve sipas meritave dhe aftësive.

Njerëzit dhe energjitë më pozitive janë lënë jashtë këtij sistemi banal, prandaj forca e vërtetë është në pritje dhe e gatshme për ndërtimin e një shteti modern me ekonomi dhe shoqëri të zhvilluar.

Futja e njerëzve të rinj në sistem, përbën një garanci fillestare dhe jo absolute sepse nuk siguron mos përfshirjen e tyre në afëra korruptive në të ardhmen për të devijuar përsëri shtetin nga shinat e interesave kombëtarë.

Për një "produkt" të shëndetshëm duhet të jenë të shëndetshme jo vetëm **fara** por dhe **ara**.

Ne nuk besojmë tek supernjeriu, jemi të ndërgjegjshëm se çdo formë pushteti pa kontroll të korrupton, prandaj jemi me popullin kur thotë: *"vetëm frika ruan vreshtin"*.

Rikonceptimi i institucioneve duhet të jetë i tillë që të pengojë akumulimin e çdo forme pushteti si dhe të sigurojë kontrollin dhe ndëshkueshmërinë efektive të zyrtarëve shtetërorë. Natyrisht, ata nuk

mund të kontrollojnë vetveten sepse askush nuk ka frikë nga vetvetja. Që këtu ndarja në *pushtete adiminstruese* dhe *pushtete kontrolluese* (Action Power dhe Control Power). Nuk duhet që pushtetmbajtësit të kenë edhe arrën edhe gurin, dhe të administrojnë pasuritë publike dhe të kontrollojnë vetveten se si e kryejnë punën. Prandaj, qeveria duhet të punojë dhe qytetarët të kontrollojnë.

Ndarja sot e pushteteve është fiktive dhe nuk garanton funksionimin e shtetit të së drejtës duke krijuar një hon mes kushtetutës formale dhe asaj materiale. Si rezultat, kemi një sistem hermetik të mbyllur nga brenda ku kasta kontrollon partitë, partitë kontrollojnë parlamentin dhe parlamenti vë institucionet në shërbim të kastës.

Problemi i parë mbetet **çmontimi i strukturave** të kësaj kaste dhe krijimi medoemos i mekanizmave parandalues që interesa antishqiptarë mos të deformatojnë përsëri vullnetin e popullit sovran. Nuk do jenë më pushtetarët që do emërojnë pushtetarët, por do jenë direkt qytetarët që do zgjedhin dhe shkarkojnë në çdo moment zyrtarët e lartë për të shkëputur lidhjet korporative mes tyre dhe për të togëzuar makinën shtetërore me vullnetin e qytetarëve.

Aktualisht kontakti i popullit sovran me shtetin një herë në katër vjet, është i dobët dhe fiktiv sepse nuk arrin të pengojë kapjen e shtetit nga këto struktura që ndjekin një axhendë të kundërt me detyrimet kushtetuese. Duhet krijuar më shumë pika kontakti mes sovranit dhe makinës shtetërore, në një ndërveprim dhe komunikim të vazhdueshëm për hartimin e politikave publike dhe për një qeverisje të mirë. Pjesëmarrja e vazhdueshme e qytetarëve në ndërtimin e institucioneve

luan dhe një rol **higjenizues** pasi u lejon qytetarëve të parandalojnë krijimin e kastave, të ndëshkojë korrupsionin dhe sjelljet devijuese duke rritur cilësinë dhe promovuar meritokracinë.

S.O.S. nuk kërkon instalimin e demokracisë direkte të pastër, në një shoqëri pluraliste dhe një botë që kërkon zgjidhje të shpejta dhe të kualifikuara, por këto zgjidhje nuk mund ti shpëtojnë kontrollit dhe konsensusit qytetar si ndodh sot. Prandaj, gërshetimi i mekanizmave të demokracisë direkte me demokracinë përfaqësuese, në atë që njihet si demokracia pjesëmarrëse, është sot rruga më e mirë dhe në harmoni me zhvillimet politiko-sociale në Europë. Një sistem ku qytetarët vendosin jo vetëm për “njerëzit” por dhe për “**gjërat**” ose politikat publike.

Në erën e informimit, qytetari modern do kërkojë gjithmonë e më shumë të përfshihet direkt në jetën publike duke deleguar më pak pushtet elitës përfaqësuese. Në krizë sot është pikërisht ky raport përfaqësimi, sepse interesa të mëdha ekonomiko-financiare, brenda dhe jashtë, synojnë të devijojnë vazhdimisht vendimarrjen politike kundër interesit publik dhe vullnetit të sovranit.

Garancitë e konceptuara në 1700, sot nuk arrijnë të mbrojnë plotësisht demokracinë nga rreziqet dhe grabitqarët e erës moderne. Prandaj, demokracia duhet të përditësojë vazhdimisht mekanizmat e saj për të mbrojtur efektivisht të drejtat e qytetarëve dhe interesat ekonomikë kombëtare në epokën e një konkurrence globale.

Shqipëria doli nga izolimi në një oqean global, me mundësira por dhe dallgë të mëdha, prandaj duhet ndërtuar një “anije” moderne dhe kapitenë të zotë dhe jo piratë militantë dhe injorantë.

Për këtë arsye, **vizioni** ynë nuk është të përmbysim rendin kushtetues, por krejt e kundërta, ta bëjmë atë efikas në jetët e njerëzve dhe jo vetëm në letër. Qytetarët nuk do jenë më spektatorë pasivë të një politike autoreferenciale, por pjesëmarrës aktivë në fatet e vendit dhe ndërtimin e institucioneve publike, të një shteti që të jetë shtëpia jonë e përbashkët. Një shtet nga qytetarët për qytetarët!

Shina e parë - Demokracia

Një shtet nga qytetarët për qytetarët

Sfida më e madhe e shqiptarëve ka qenë aftësia e shtet-ndërtimit. Një shteti në kuptimin e një entiteti racional që konfiguron interesin publik dhe përdor mjete demokratike për realizimin e qëllimit të përgjithshëm. Në vakum të shtetit, shoqëria, ekonomia, arsimit, arti dhe kultura banalizohen dhe shkojnë drejt degradimit të vazhdueshëm. Historia 25 vjeçare i ngjason asaj komuniste, ku shteti identifikohet me monopolin e një pushteti maniak dhe pa kontroll, veçse tani dhe më keq sepse interesi publik është zëvendësuar me interesa klientelistë dhe antikombëtarë.

Po pse ka ardhur kjo? Është faji i popullit? A ka vendosur populli apo "elitat" për fatet e vendit: për mos hapjen e dosjeve dhe faljen e xhelatëve të regjimit, për shkatërrimin e sistemit të drejtësisë, për shkatërrimin e ekonomisë, pronës private dhe publike, për shkatërrimin e arsimit, për shkatërrimin e ushtrisë, transparencës së kapitalit, për privatizimet e pasurive kombëtare, për borxhin e frikshëm publik, për përdorimin e partive si brigada plaçkitëse, për betonizimin e qyteteve, bregdetit e kështu me radhë?

Sigurisht që jo JO! Por prapë sistemi, politika, media dhe pseudo-intelektualët fajësojnë popullin për gjithë këto fatkeqësi. Por ky popull martir këto 25 vite jo vetëm që punoi dhe sakrifikoi rrugëve dhe deteve të botës, por dhe reagoi! Jo vetëm me votime alternative dhe rotacion por

dhe me protesta që mbushën sheshet dhe rrugët e këtij vendi, madje me kosto jetësh!

E vërteta është se vullneti i popullit u deformua dhe u vodh nga një “elitë” që nuk besonte tek demokracia por mendonte vetëm për pushtet dhe privilegje duke shitur interesat kombëtarë! Korrupsioni solidar dhe fajësimi i qytetarëve është ideologjia e sotme që mban në këmbë këtë sistem të udhëhequr nga një “elitë” antikombëtare.

Por si do dalim nga ky kurth i sajuar?

Rruga më e thjeshtë do të ishte një zgjidhje nga sipër ose ndryshimi i elitës. Por kjo është e pamundur në kushtet e sotme, jo sepse nuk ka një elitë të vërtetë, por sistemi kontrollon çdo kanal për neutralizimin e “të rinjve” duke i klonuar ose linçuar. Prandaj, shpresa e vetme realiste, mbetet përfshirja e popullit në ndryshimin e sistemit dhe ndërtimin e institucioneve supergarantiste për të drejtat e tyre.

Për herë të parë pas 100 viteve shtet, është koha të ndërtojmë ato mekanizma institucionalë që u sigurojnë qytetarëve kontrollin e makinës shtetërore, si garancia më e mirë për mbrojtjen e të drejtave të Njeriut, realizimin e shërbimeve publike dinjitoze, zhvillimin e një ekonomie kombëtare që siguron mirëqënie dhe punësim për të gjithë qytetarët. Sot shqiptarët janë të shpronësuar nga e drejta e tyre sovrane dhe partitë i janë mbivendosur vullnetit popullor dhe Kushtetutës. Partitë politike dhe kasta e tranzicionit dështuan në ndërtimin e demokracisë shqiptare, tani fjala u takon qytetarëve!

Nuk është vonë të rimarrim të drejtën tonë sovrane **tani** dhe **këtu!**

1. **Modifikim i Kushtetutës me referendum.**

Kushtetuta e sotme nuk është ajo që shqiptarët votuan në 1998, sepse partitë e ndryshuan pa marrë pëlqimin e qytetarëve. Garancitë kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe funksionimin e shtetit të së drejtës janë paralizuar. Tashmë sistemi kushtetues, i ngjan një bunkerit të mbyllur nga brenda sepse të gjithë mekanizmat për ndryshimin e tij janë në duart e kastës, që e hap dhe e mbyll sipas oreksit.

Hapja e sistemit dhe demokratizimi i tij, kalon nëpërmjet përvetësimit të këtyre instrumenteve në duart e popullit që të ndërtojë vetë institucionet shtetërore. Prandaj, Modifikim i Kushtetutës do të bëhet me referendum të detyrueshëm propozues dhe shfuqizues, me iniciativë popullore, për të mbrojtur ligjin themelor dhe të drejtat e qytetarëve prej lojërave të pushtetit.

2. **Parashikimi i referendumeve ligjore propozues dhe shfuqizues pa kuorum.**

- A. **Referendume detyruese** për: 1. Privatizimet e pasurive publike 2. Rritja e borxhit publik 3. Miratimi i strategjive të rëndësishme kombëtare 4. Aderimi në organizata ndërkombëtare 5. Miratimi i planeve të rregullimit të territorit
- B. **Referendume fakultative.** Brenda 90 ditëve nga miratimi i ligjit në Parlament dhe para hyrjes në fuqi, 50.000 qytetarë

kanë të drejtë të thërrasin referendum për aprovimin e tij. Kjo do dekurajojë përfaqësuesit e popullit të aprovojnë ligje që nuk gëzojnë mbështetje popullore. Në këtë mënyrë llogaridhënia e secilit deputet, nuk bëhet më 1 herë në 4 vjet por për çdo veprim të kryer nga përfaqësuesit. Heqja e kuorumit për vlefshmërinë e referendumit, zgjeron debatin publik dhe rrit pjesëmarrjen aktive të qytetarëve sepse të gjitha forcat politike detyrohen të shprehen e të bëjnë thirrje pro ose kundër tij.

3. Aprovimi i ligjit patriotik për "karantinë" të detyruar ndaj ish zyrtarëve të lartë. Pezullimi i përkohshëm (4 vjet) nga detyrat shtetërore të gjithë zyrtarëve të lartë që kanë shërbyer këto 25 vite, deri sa organet e drejtësisë të vihen në punë, është rruga e vetme për *Normalizimin* e vendit. Përndryshe çdo reformë do të deformohet nga efektet toksike që kjo kastë do të ushtrojë mbi organet dhe titullarët e tyre. Pjesëmarrja në administratën shtetërore nuk do cilësohet thjesht si e drejtë por si shërbim me interes publik dhe e disponueshme për të gjithë qytetarët në bazë të meritave dhe aftësisë.

4. **Konstitucionalizimi i partive politike.**

Krijimi i një shteti shqiptar të së drejtës kërkon ndarjen përfundimtare ndaj modelit të partisë-shtet që i mbivendoset Kushtetutës dhe ligjit. Krijimi i pluralizmit nuk pengoi por transformoi në rotacion, vazhdimin e mendësisë komuniste mbi një parti që vendos për gjithçka dhe për këdo. Njësoj si më parë, institucionet dhe gjithë administrata vihen në shërbim të partisë së radhës dhe jo Republikës. Është partia që të gjen punë, të bën të pasur, të jep privilegje dhe të siguron pandëshkueshmëri.

Sundimi i partisë nga lart dhe jo organizim nga poshtë (*qytetarët*), ku udhëheqësi zgjedh strukturat dhe njerëz besnikë që i sigurojnë pushtet absolut është antidemokratik dhe duhet të përfundojë. Partitë duhet të rikthehen në frymën e Kushtetutës, ku luajnë një rol ndërmjetësuesi e kontrolli të qytetarëve mbi shtetin, ku prodhohen ide dhe përfaqësohen interesa për të ndikuar vendimmarrjen publike.

Për këto dhe më tepër, organizimi demokratik i partive do të rregullohet me rezervë kushtetuese dhe ligjore, dhe zbatimi i tyre nuk do u lihet në dorë më vetë partive dhe statuteve të tyre, por do garantohen nga gjykatat shqiptare dhe KQZ-ja e zgjedhur prej qytetarëve.

A. **Parashikimi në Kushtetutë i sistemit të Primareve të hapura.** Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën politike do të bëhet nëse atyre u njihet një rol më i zgjeruar në vendimmarrje duke zgjedhur lidera të moderuar.

1. Qytetarët do të mund të zgjedhin direkt kryetarin e partisë dhe drejtuesit e tjerë lokalë. Zbatimi i parimit “një qytetar, një votë” nuk do lihet më në dorë të kryetarit, por do të jetë automatik. Do parashikohet gjithashtu mekanizmi i rishikimit të mandateve në çdo kohë, me anë të një nisme qytetare.

2. Kandidatët për zgjedhje politike dhe vendore, nuk do të parapërcaktohen nga udhëheqësi, por do të votohen më parë nga qytetarët.

- B. **Kufizimi vetëm në Dy mandate, për çdo post drejtuesi.** Kjo lejon ripërtëritjen e strukturave me njerëz dhe ide të reja si dhe pengon kapjen e partive nga grupime që punojnë kundër interesit të përgjithshëm.
- C. **Krijimi i një tavani për financimin.** Që gara elektorale të jetë e ndershme duhet që ajo të mbështetet tek idetë dhe njerëzit dhe jo tek paratë e shpenzuara dhe blerja e influencave.
- D. **Transparencë totale.** Krijimi i Drejtorit të thesarit të çdo partie që do jetë penalisht përgjegjës për çdo veprim financiar i të partisë publikuar online në përputhje me normat ligjore.

5. **Zgjedhje e drejtpërdrejtë nga qytetarët të zyrtarëve të lartë të Republikës.** Shpronësimi i sovranitetit popullor dhe marrja në kontroll e shtetit nga grupime të ndryshme evitohet vetëm nëse pushtetarët nuk emërojnë më

njëri-tjetrin, por zgjidhen dhe shkarkohen direkt nga qytetarët. Organet e kontrollit të vendit nuk do të lihen më në dorë të partive, të cilat do të merren vetëm me administrimin e vendit sipas mandatit të besuar nga populli.

Kandidimi i personave do të rregullohet me ligj dhe fushata për zgjedhjen e tyre nuk do jetë politike por teknike garantuar nga një mbulim mediatik i barabartë. Zgjedhja do të bëhet me dy raunde, ku në raundin e dytë do të garojnë dy më të votuarit në raundin e parë.

A. Presidenti i Republikës. I cili duhet ti qëndrojë larg lojës politike që të mund përfaqësojë realisht unitetin e popullit shqiptar.

B. Anëtarët e KQZ -së (Komisioni Qendror i zgjedhjeve). Komisioni do të përbëhet prej 5 anëtarësh me afat 5 vjeçar, i cili do rinovohet çdo vit me një anëtar të ri. Mandati i anëtarëve të parë nuk do të jetë i plotë, pasi përparësi ka rinovimi i institucionit me njerëz të rinj dhe legjitimitet të freskuar, duke garantuar kështu dhe vazhdimësinë juridike. E drejta e votës dhe të drejta të tjera politike nuk do nëpërkëmben më nga partitë dhe interesa kriminale në vend.

C. Anëtarët e KLD-së (Këshilli i Lartë i Drejtësisë). Korporata e magjistratëve duhet të marrë fund duke e rikthyer gjykatësin në shërbim të Republikës dhe zbatim të ligjeve të saja. Këshilli do të përbëhet prej 5 anëtarësh me afat 5 vjeçar, i cili do rinovohet çdo vit me një anëtar të ri. Mandati i anëtarëve të

parë nuk do të jetë i plotë, pasi përparësi ka rinovimi i institucionit me njerëz të rinj dhe legjitimitet të freskuar, duke garantuar kështu dhe vazhdimësinë juridike.

- D. Prokurori i Përgjithshëm i Republikës.** Nëse interesi publik i Shqipërisë ka mbetur jetim, kjo është në radhë të parë për shkak të mosushtrimit të akuzës penale prej prokurorëve të vendit. Simbioza e prokurorit me politikën duhet të marrë fund duke e nxjerrë institucionin nga kthetrat e shumicave parlamentare dhe duke e vënë në kontroll të drejtpërdrejtë të qytetarëve.
- E. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.** Në mënyrë që Prokuroria të bashkëpunojë efektivisht me policinë në luftën ndaj korrupsionit dhe krimit shtetëror duhet që policia të dalë nga kontrolli i politikës dhe të vihet realisht në shërbim të popullit.
- F. Kryetari i Gjykatës së Llogarive,** e cila do zëvendësojë Këshillin e Lartë të Shtetit aktual duke rritur rolin e kontrollit ndaj aktivitetit financiar të makinës shtetërore.
- G. Avokati i Popullit** i pazgjedhur nga populli por nga politika nuk mund të mbrojë realisht qytetarët nga dhunimet e administratës shtetërore. Legjitimimi i Avokatit të popullit në proceset gjyqësore do të ishte një hap i duhur që roli i tij mos të mbetet thjesht simbolik.
- H. Drejtori i Shërbimit Kombëtar të Transparencës,** i cili do jetë përgjegjës për transparencën proaktive, të plotë dhe online të gjithë veprimtarisë shtetërore dhe pasurive të çdo

zyrtari publik. Shërbimi Kombëtar i Transparencës do të jetë i pavarur dhe i shtrirë në mënyrë kapilare në zyrat e administratës publike.

- I. **Drejtori i ISTAT.** Publikimi i shifrave dhe statistikave të sakta dhe të besueshme është themelor për njohjen e publikut me ecurinë e aktivitetit shtetëror dhe ekonomisë së vendit. Prandaj ky institucion duhet të shpëtojë nga kontrolli i politikës dhe të vihet në shërbim të gjithë aktorëve publikë dhe privatë në vend.
- J. **Drejtori i Përgjithshëm i AMA-s.** E drejta kushtetuese e informimit është thelbësore për formimit e opinionit publik dhe ushtrimin e të drejtave politike për funksionimin normal të demokracisë, shoqërisë dhe ekonomisë. Është detyrë e shtetit demokratik që të garantojë që pushteti i medias në erën e sotme të ushtrohet si çdo pushtet tjetër në përputhje me garancitë kushtetuese dhe ligjore. Duhet që informacioni të kontrollojë politikën dhe jo e kundërta si ndodh sot.
- K. **Drejtori i RTSh-së.** Televizioni publik duhet tu merret partive dhe t'iu rikthehet shqiptarëve. Rrënimi i RTSh-së është vepër e pushtetit për të kontrolluar informimin si dhe për të kënaqur klientët e televizioneve private. Informimi mbi artin, kulturën, sportin dhe të tjera aktivitete jokomerciale janë detyrim kushtetues dhe prandaj duhen të promovohen nga televizioni publik.
- L. **Drejtorin e Përgjithshëm të Konkurrencës.** Konkurrenca është kushti themelor i funksionimit të ekonomisë së tregut

dhe mbrojtjes së të drejtave të konsumatorit prej pozitive dominuese të monopolistëve kombëtare apo ndërkombëtarë.

M. Drejtorin e Përgjithshëm të Konkurseve Publike. Epoka e administratës mbushur me militantë dhe injorantë duhet të përfundojë. Të gjitha emërimet e nëpunësve civilë do kryhen nga një organ qendror me procedura super transparente. Provimi dhe vlerësimi i njëkohshëm do transmetohen on streaming dhe në një kanal dytësor publik. Largimi i çdo mundësie manipulimi është garancia më e mirë për objektivitet të rezultateve. Në këtë mënyrë, konkursi publik do të kthejë në shërbim të Republikës njerëzit dhe energjitë më të mira pasi do të shndërrohet në instrumentin e vetëm për hyrjen në administratën publike, ashtu si Kushtetuta e kërkon.

6. Rishikimi popullor (recall). Kriza e raportit të përfaqësimit mes të zgjedhurve dhe zgjedhësve mund të kapërcehet vetëm nëse ky mandat bëhet objekt kontrolli në çdo moment dhe jo vetëm 1 herë në 4 vjet. Fushatat e premtimeve dhe mllefi i zhgënjimeve mund të marrë fund vetëm nëse qytetarët e "mbajnë butonin" në dorë dhe kërkojnë të rishikojnë këtë raport besimi me të zgjedhurin e tyre në çdo kohë.

Frika për humbjen e mandatit do të mbajë të togëzuar përfaqësuesit (deputetë dhe kryetarë bashkish) me zgjedhësit e tij duke u përkujdesur vazhdimisht për zbatimin e këtij vullneti.

Ndryshe nga pushtetarët, populli është i interesuar të korrigjojë gabimin e vet nëse gabon. Llogaridhënia për secilin përfaqësues nuk bëhet më në bllok por individualisht dhe në çdo moment të ushtrimit të mandatit.

Kështu çdo mandat i përfaqësuesve të popullit do të rishikohet në çdo moment, nëse për këtë bëjnë kërkesë pa motivim, 20.000 mijë zgjedhës ose 1/5 e tyre në rastet e tjera. Është detyrë e Republikës të promovojë dhe financojë organizimin e nismave qytetare nëpërmjet një zyre kombëtare të veçantë. Interesi kombëtar do të kompozohet nga poshtë ashtu si shqiptarët kanë ditur të bëjnë nëpër shekuj.

7. Vota për emigrantët dhe krijimi i një

nëndhome parlamentare të diasporës shqiptare. Kjo do të ketë funksione vendimmarrëse për çështje të rëndësishme kombëtare dhe këshillimi në rastet e tjera. Vetëm me institucionalizimin e diasporës shqiptare, do përfundojë instrumentalizimi i saj nga politika shqiptare dhe do rivitalizohen energji të mëdha që kombi ynë disponon në ta katra anët e botës. Procedurat e përzgjedhjes të saj do rregullohen me ligj të veçantë.

8. Vetëm dy mandate për zyrtarët e lartë

shtetërorë. Për të kthyer besimin e njerëzve tek politika si një aksion komunitar për përmirësimin e jetës, duhet zëvendësuar

ideja e një politike burim privilegjesh me një politikë në shërbim të qytetarit. Që të merren vendime të drejta për qytetarët, pushtetarët duhet të jenë afër problemeve të tyre dhe qëndrimi për një kohë të gjatë në pallatet e pushtetit josh çdo person të sakrifikojë interesin publik me privilegje, në një qark që synon konsolidimin e pushtetit.

Kjo pengon qarkullimin e ideve dhe njerëzve të rinj në sistem. Sot të "të rinjtë" kanë akses në sistem vetëm nëpërmjet një procesi klonimi ku pushteti ripërtërihet me trapiante të reja.

Epoka e politikanëve të përjetshëm duhet të përfundojë dhe ata ti kthehen punës normale si çdo qytetar i Republikës. Dy mandate janë të mjaftueshme për të dhënë një kontribut të vlefshëm institucioneve shtetërore dhe për të vazhduar të japësh atë kontribut dhe në fusha të tjera të komunitetit. Pjesëmarrja në punët shtetërore nuk do shihet më si privilegj por si një shërbim publik dhe kjo mundësi duhet ti jepet sa më shumë qytetarëve në bazë të meritave dhe ndershmërisë.

9. **Juritë qytetare.** Ky institut nuk është i panjohur për eksperiencën juridike shqiptare dhe rregull për shumicën e demokracive perëndimore, ku populli përfshihet në të tre pushtetet. Integrimi i gjyqtarëve aktualë më një juri qytetare, e zgjedhur me short e cila do të merret me çështjet faktike, mbi ekzistencën e krimit dhe fajësisë, kurse gjyqtari do të merret vetëm me kualifikimin juridik, motivimin dhe përcaktimin e masës

së dënimit. (sipas shembujve të Evropës Kontinentale). Kjo nga një anë do të reduktonte superpushtetin që ka gjyqtari sot, do e bënte atë më të përgjegjshëm, kurse nga ana tjetër do i lehtësonte barrën gjyqtarit prej presioneve të ndryshme që vijnë prej një pozicioni permanent, sepse juria vendos në fshehtësi të plotë. Zgjedhja me short, mbarimi brenda një kohe të shkurtër, izolimi i anëtarëve të jurisë dhe mekanizma të tjerë përbëjnë një garanci të mjaftueshme për integritetin e jurive, ndryshe nga korrupsioni total që ka përfshirë magjistratët e sotëm.

Ndarja e roleve procesuale në këtë drejtim, jo vetëm që rrit garancitë e të akuzuarit (sepse tani do të gjykohet nga “të barabartët e tij”) por do të përmirësonte dhe punën e magjistratëve dhe të avoketërve, që tani nuk do kërkojnë shtigje korrupsioni por do përgatisin më mirë çështjet dhe tezat para jurive, duke rritur kështu nivelin e Jurisprudencës shqiptare dhe kulturën juridike në vend.

10. **Riformatim i sistemit të Drejtësisë**, ndër të tjera:

- A. Futja e 500 magjistratëve të rinj në sistem me konkurs
- B. Rishikimi i pasurive të magjistratëve aktualë sipas ligjit antimafia dhe pezullimi në rast të mos justifikimi të pasurisë së vënë
- C. Shkrija e shkollës së magjistraturës dhe aksesit në sistemin e drejtësisë nëpërmjet insitutit kushtetues të Konkursit Publik, për ti hapur rrugë profesionistëve të ndryshëm të së drejtës dhe prishjen e lidhjeve korporative.

11. Reforma të tjera:

A. Korrupsioni nga zyrtarët e lartë shtetërorë (ministra, deputetë dhe magjistratë) do të cilësohet si tradhti ndaj Republikës me burgim të përjetshëm.

B. eGovernment – Qeverisja elektronike. Shqipëria duhet të transformohet si pjesa tjetër e Evropës, në një shoqëri dhe ekonomi e bazuar mbi njohurinë, falë përdorimit të eGovernment. Ideja e institucioneve që qeverisin popullsinë “top-down” (nga lart-poshtë), po zhduket në gjithë Europën. Tendencat socialo-ekonomike të globalizimit “nga sipër” dhe përforcimi i shoqërisë civile “nga poshtë” po krijon modelin e qeverisjeve policentrike, shumë nivelesh për një rregullim më të mirë të shoqërive bashkëkohore ku në qendër është “komuniteti”. Kjo nuk duhet ngatërruar me karikaturat e tanishme: portale gjysmake, sporadike, segmentare dhe pa asnjë lloj kontrolli. Modernizmi i shtetit dhe përmirësimi i shërbimeve publike kalon nëpërmjet qeverisjes elektronike, ku mundësia për korrupsion dhe abuzim pothuajse azerohet ashtu si dhe ulen shpenzimet qoftë të shtetit ashtu dhe të qytetarit dhe operatorëve të tjerë.

C. Transparencë totale ndaj korrupsionit total. Kultura e përhapur e korrupsionit gjen vaksinën më të mirë tek transparenca totale e akteve dhe pasurive. Nocioni i transparencës proaktive, ku i gjithë aktiviteti shtetëror

publikohet online pa nevojën e kërkesës nga qytetarët dhe diskrecionin burokratik të administratës. Ky shërbim nuk do i lihet në dorë qeverisë e cila “ngatërron” transparencën me informacione pa vlerë dhe deklaratat për shtyp, por do të realizohet nga një shërbim i jashtëm dhe i shtrirë në të gjithë zyrat e administratës. Do krijohet Shërbimi Kombëtar i Transparencës, drejtori i të cilit do të zgjidhet direkt nga qytetarët me një mandat 5 vjeçar. Pasuria e pushtetarëve nuk do bëhet me short por për të gjithë dhe e publikuar on line, shoqëruar me dënime të ashpra dhe jo thjesht me gjobë.

D. Sekuestrim dhe konfiskim i pasurive të pajustificuara të pushtetarëve nga 1991 e deri më sot. Ligji antimafia do të jetë operativ dhe së bashku me agjenci të huaja do hetohen pasuri të depozituara jashtë Shqipërisë duke u kthyer shqiptarëve pasuritë e vjedhura.

E. Votim Elektronik. (referendume dhe votime). Deputetët e Parlamentit shqiptar do të zgjidhen me votim elektronik sipas eksperiencave më të mira botërore dhe në një sistem zgjedhor proporcional rajonal me numër të barabartë mandatesh dhe me lista të hapura. Perfeksionimi i mekanizmave për të realizuar barazinë gjinore duhet të mbetet prioritet për të dalë nga një sundim i politikës prej burrave dhe përdorimi i grave si dekorime të shefit të partisë.

Përsa i përket pushtetit vendor, sistem proporcional (këshillat bashkiakë) dhe mazhoritar me dy raunde për kryetarin e bashkisë.

F. Goditja e krimit elektoral. Personat që shesin votën përveç dënimit të rëndë do përjashtohen nga e drejta e votimit për 10 vjet. Partitë që përdorin strukturat e tyre për influencim të paligjshëm të votës do përjashtohen nga zgjedjet dhe krerët e tyre do dënohen për Atentat ndaj Kushtetutës.

G. Krijimin e institutit të përgjegjësisë civile për çdo funksionar publik (përfshirë dhe magjistratët) në mënyrë që riparimi i dëmit të padrejtë të shkaktuar ndaj qytetarit, ti ngarkohet direkt titullarit të organit që ka abuzuar me ligjin dhe jo Shtetit. Kjo masë do të mbajë larg të paaftët nga administrata publike dhe do përmirësojë shërbimin publik në të mirë të qytetarëve.

H. Peticionet të detyruara për shqyrtim. Pjesëmarrja e qytetarë në politikat e vendit do të shprehet dhe me nënshkrime të peticioneve (dhe online) për probleme të ndryshme. Arritja e një numri të caktuar nënshkrimesh krijon detyrimin që organet kolegjiale ti marrin ato në shqyrtim. Edhe pse organet nuk janë të detyruara ti pranojnë, diskutimi i tyre detyron politikën të marrë qëndrim dhe kosto përballë opinionit publik

I. Pjesëmarrja qytetare në administrimin e buxhetit

vendor. Demokracia Pjesëmarrëse zbatohet shumë lehtë në politikat vendore ku problemet janë më të prekshme për qytetarët. Prioritetet nuk do të vendosen nga pushtetarët dhe klientët e tyre por direkt nga qytetarët sipas eksperiencave tashmë të kolauduara në vendet e tjera. Fushatat elektorale nuk do jenë marketing premtimesh por diskutime idesh dhe propozimesh.

J. Reduktimi i noterisë dhe vlerësimi i

vetëdeklarimit. Shqiptarët janë i vetmi popull në Evropë, që në erën dixhitale, iu duhet të noterizojnë çdo dokument duke rënduar dhe më tej ekonomitë e tyre. Numri 10 fish më i lartë se në vendet perëndimore i numrit të noterëve, shitja apo dhurimi i liçencave është një tjetër perversitet i këtij shteti antiqytetar. Propozojmë rikthimin e vetëdeklarimit dhe kontratave mes palëve pa nevojën e figurës së noterit. Krijimi i një qeverie elektronike dhe forcimi penal i deklarimit të rremë si vepër e rëndë penale janë rruga e duhur për lehtësimin e jetëve të qytetarëve.

K. Zhdukja e inaugurimit të veprave publike.

Praktika e shëmtuar e inaugurimit e punëve elektorale do përfundojë. Tenderat do kthehen të jenë transparente, ku do sigurohet fatura financiare, afatet dhe cilësia e tyre.

L. Luftë totale nga krimi. Eksponentët kriminale nuk duhet të gëzojnë pasuritë e tyre si dhe të degradojnë të rinjtë dhe të rehat e vendit me antimodelet e tyre në shoqëri dhe ekonomi.

Shina e dytë - Ekonomia

Punësim, zhvillim, shërbim

Ashtu si theksuam më sipër problemi i ekonomisë shqiptare nuk kanë qenë programet në letër të të gjitha partive por mungesa e vullnetit për ti realizuar ato. Elitat politike zaptuan shtetin për të krijuar privilegje personale në dëm të interesit publik dhe ekonomisë së tregut. Pas perdes së liberalizmit ekonomik, pushtetarët postkomunistë; privatizuan dhe monopolizuan të gjithë sektorët e ekonomisë duke paralizuar zhvillimin e vendit dhe realizimin e të drejtave ekonomike sociale të parashikuara në Kushtetutë.

Prandaj S.O.S. synon së pari të çlirojë ekonominë nga interesat antikombëtarë dhe kthejë shtetin në binarët e Kushtetutës duke aktivizuar të gjitha mekanizmat që disponon një vend sovran për hartimin e një strategjie kombëtare të zhvillimit që siguron punësim dhe mirëqenie për të gjithë qytetarët shqiptarë.

Pa këto mekanizma operatorët ekonomikë në vend nuk arrijnë të bashkërendojnë energjitë e tyre në një klimë besimi, e domosdoshme për çdo proces prodhimi.

Në erën globale, Shqipëria si çdo vend tjetër, duhet të dijë të mbrojë interesat e saj ekonomike, por kjo nuk mund të bëhet nëse në krye të hallkave ekonomike nuk kthehet meritokracia, përgjegjësia dhe transparenca.

Sot Shqipëria mbetet një xhuxh ekonomik dhe gjigand në korrupsion. Kjo lidhje perverse mban zhvillimin e vendit 10 fish nën potencialin e tij të zhvillimit. Këtu nuk bëhet fjalë thjesht për korrupsion, por për instalimin e një kaste antikombëtare që sabotoi të gjitha reformat që i duheshin zhvillimit të ekonomisë së tregut si: rregullimi i qartë i pronës, transparencës së kapitalit, sistemit të drejtësisë dhe funksionimit të ligjit, konkurrencës së ndershme etj. Ajo që u prodhua ishte një kaos ku përfituan vetëm grabitqarë kombëtarë dhe ndërkombëtarë që kalonin nëpër kanalet e pushtetit. Institucioni i tregut të lirë i cili shërben si rregullator i kërkes-ofertës nuk funksionon si pasojë e monopoleve dhe oligopoleve ekonomike.

Prandaj është urgjente çlirimi nga kjo kastë dhe realizimi konkret i reformave që mundëson zhvillimin e ekonomisë dhe shpërndarjen e drejtë të pasurisë.

Vizioni shqipON nuk është fanatik i asnjë ideologjie, por praktik dhe strategjik për t'iu përgjithgjur realisht nevojave të shoqërisë dhe ekonomisë shqiptare në erën e re moderne.

Shoqëria njerëzore plotëson nevojat e saja nëpërmjet organizmit në një shtet demokratik dhe në një ekonomi të tregut. Bashkëjetesa e tyre është e domosdoshme sepse zhdukja e njerit në favor të tjetrit është jo vetëm utopike por e rrezikshme për shoqërinë dhe emancipimin universal të Njeriut. Është detyrë e Republikës të heqë të gjitha pengesat me karakter ekonomik dhe social që duke kufizuar faktikisht lirinë dhe barazinë e qytetarëve pamundësojnë zhvillimin e plotë të njeriut dhe pjesëmarrjen e tij në jetën politike, ekonomike dhe sociale të vendit.

Prona private dhe ekonomia e tregut janë themeli i rendit shoqëror dhe Shteti duhet të garantojë me të gjitha format që iniciativa e lirë dhe konkurrenca e ndershme të prodhojnë punësim dhe mirëqenie materiale dhe shpirtërore për të gjithë qytetarët.

Prandaj ekonomia duhet të vihet në shërbim të shoqërisë dhe jo e kundërta, ashtu si dhe kultura konsumiste ti lërë vendin kulturës relacionale dhe solidare mes qytetarëve. Prirja drejt një rritje ekonomike negative krijon një çekuilibër gjigand mes plotësimit të nevojave tona materiale dhe nevojave tona relacionale. Për këtë arsye është thellësisht i nevojshëm, hartimi i një programi reformash ekonomike dhe sociale për krijimin e një shoqërie komunitare.

Shqiptarët eksperimentuan këto 25 vite të kundërtën e mendësisë komuniste, duke menduar se mirëqenia mund të arrihet vetëm individualisht. Jemi dëshmitarë të shkatërrimit të qyteteve dhe hapësirave që në vendet perëndimore mundësojnë lidhjet njerëzore dhe përmirësimin e jetëve nëpërmjet aksionit kolektiv. Inercia dhe vakumi i shtetit social në përmbushjen e këtij detyrimi kushtetues nuk mund të zëvendësohet nga aktiviteti i aktorëve privatë shqiptarë apo ndërkombëtarë.

Fanatizmi drejt tregut ka krijuar iluzionin se ai është zgjidhje për të gjitha raportet e shoqërisë sonë ashtu sikundër mendonim në komunizëm se shteti është zgjidhja për gjithçka.

Tregu është një instrument efikas për të krijuar një rritje ekonomike. Kështu që sigurisht ai rregullon dhe mirëqenien tonë materiale dhe

shpirtërore, por vetëm nëse përdoret në mënyrë inteligjente. Të përdorësh tregun në mënyrë inteligjente do të thotë që të kuptojmë dhe efektet negative që ka konkurrenca e tejskajshme mbi formimin tonë kulturor. Ndërtimi dhe mirëmbajta e rrjetit të relacioneve dhe kohezionit social varet pra nga ekuilibri që krijon shteti me tregun. Prandaj duhen korigjuar efektet negative të tregut dhe konkurrencës kur tentohen të futen në çdo sferë të jetës sociale si e vetmja mënyrë e të parit dhe kuptuarit të botës si totalitarizëm i versionit modern.

Sot shqiptarët ndihen të pafuqishëm sepse sistemi pervers që është prodhuar, të detyron ta pranosh situatën si fenomen natyror, të pandryshueshëm, ndaj të cilit duhet veçse *“të mësohesh”*. Njeriu në fakt disponon edhe aftësinë tjetër për të ndryshuar botën së bashku nëse çlirohet nga pengesat dhe format e ndryshme të nënshtrimit.

Prandaj vizioni shqipon është emancipues sepse kërkon ti japë qytetarit mundësi dhe instrumente, për ta nxjerrë nga gjendja e izolimit dhe për ta bërë pjesë aktive të një projekti të përbashkët ekonomik-shoqëror.

Ky projekt do bazohet tek:

1. Krijimi i një modeli ekonomik të qëndrueshëm
2. Krijimi i vendeve të punës me cilësi
3. Çlirimi i ekonomisë nga monopolistët dhe rritja e aftësisë konkurruese
4. Mbrojtja e personave në nevojë, duke ulur pabarazinë në vend dhe diskriminimin gjinor

12. Punësimi. Për të nxitur rritjen ekonomike dhe ulur papunësinë e madhe, politikat makroekonomike duhet të synojnë zgjerimin e kërkesës agregate duke e bërë të qëndrueshme me ritimin e krijimit të vendeve të punës. Pavarisht retorikave të politikës këto 25 vite, duhet urgjentisht të kalojmë në një ekonomi prodhuese dhe jo spekulative, mbështetur vetëm tek shërbimet, importet dhe eksporti i burimeve grezzo, eskportit të krahur të punës dhe aktiviteteve kriminale.

Deri tani kemi pasur një pushtet të “fortë” dhe një shtet të dobët. Kjo situatë duhet të përfundojë në mënyrë që të krijohet një shtet demokratik dhe eficient që mos të “bëjë sehir” por të ndërhyjë me politika të ndryshme në kanalizimin e investimeve në aktivitetet që rrisin aftësinë e prodhimit vendas dhe që krijon **mijëra vende pune**.

Shqipëria disponon një forcë të madhe njerëzore dhe intelektuale me formim perëndimor dhe *know how* nga të katër anët e botës. Këto energji duhet të kanalizohen drejt një projekti të qëndrueshëm dhe afatgjatë. Shqipëria ka dalë tashmë në një ekonomi globale me konkurrencë të fortë.

Ashtu si çdo shtet tjetër, Shqipëria duhet të konfigurojë dhe të mbrojë interesat e saj ekonomike në erën globale, prandaj del si domosdoshmëri vendosja e njerëzve të aftë në të gjithë hallkat e ekonomisë dhe financë shqiptare.

Shteti duhet të dalë si garant apo në partneritet me aktorët privatë, duke ulur perceptimin e riskut dhe rritjen e kreditimit për projekte

strategjike ekonomike mbi të cilat të krijohet më tej një filiera e prodhimit vendas.

Vetëm me ndërhyrjen inteligjente të shtetit do të rriten kapacitetet menaxheriale të sipërmarrjes shqiptare duke orientuar prodhimin drejt aktiviteteve me një vlerë të shtuar të lartë, larg modeleve të call centerave apo fasonëve.

Falimentimi i shëndetshëm i të gjitha bizneseve fantazmë është i domosdoshëm për të çliruar hapësirën drejt bizneseve virtuozë.

Rikthimi në pasuri publike të aktiviteteve strategjike kombëtare si shfrytëzimi i minierave, naftës dhe telekomunikacioni është një tjetër prioritet.

Menaxhimi i borxhit publik dhe destinimi në sektorë prodhues është një tjetër prioritet dhe mundësi reale që rrjedhin prej sovranitetit të plotë fiskal dhe monetar që ende gëzojmë.

13. Platformë mbi përfitimet e integritit ekonomik Shqipëri – Kosovë.

1. Pse është e nevojshme një rritje e marrëdhënieve me Shqipërinë?
 - a. Krijimi i një poli gjeopolitik force.
 - b. Krijimi i një tregu që fillon e bëhet interesant për të huajt.
 - c. Shfrytëzimi i pasurive natyrore në mënyrë të bashkërenduar.
 - d. Bashkimi i kapacitetit intelektual.

e. Shfrytëzim i energjive të një entiteti me përqindje të lartë të popullsisë së re aktive.

2. Nevoja për krijimin e tregut të përbashkët Shqipëri – Kosovë

Për të mbështetur idenë e dobisë së tregut të përbashkët Shqipëri – Kosovë le të fillojmë nga përcaktimi i asaj që **Çfarë është një treg? Bashkësia e relacioneve ndërvepruese shkëmbyese midis aktorëve të ofertës me ata të kërkesës realizuar nën ombrellën e një kuadri të caktuar ligjor.** Do të thotë që këta aktorë bashkëveprojnë me njëri tjetrin brenda një entiteti ekonomik, duke iu nënshtruar rregullave të njëjta. Nëse këto rregulla ndryshojnë për aktorë të ndryshëm dhe/ose nuk zbatohen njësoj atëherë nuk kemi një treg të përbashkët por tregje të ndryshme, që pikërisht për këtë do të prezantojnë kosto dhe çmime më të larta relative. Nga ana tjetër nënkuptojmë që kuadri i përbashkët ligjor është një kusht i pazëvendësueshëm dhe i domosdoshëm për krijimin e një tregu të përbashkët, për bizneset. Kompetitiviteti brenda një entiteti nacional ndryshon nga ai me vendet e tjera. Në një botë ku tentohet me të gjitha mënyrat për të dalë të parët në garën kompetitive, nga ana strategjike, pa dyshim që është i nevojshëm krijimi i aleancave për tu përballur me konkurrencën. Pikërisht kjo, duhet të jetë pikënisja për shtysën që duhet t'i jepet rritjes së bashkëpunimit Shqipëri – Kosovën. Nëse ne do t'i referoheshim një ndërmarrje aksionet që ajo ndërmerr për tu përballur me ambinetin lidhen me menaxhimin me efikasitet dhe efikasitet të burimeve të brendshme, me qëllim krijimin e një avantazhi strategjik për ta përdorur në luftën e saj konkurrenciale me rivalët e saj. Pra nga njëra anë menaxhimi i burimeve dhe nga ana tjetër përballja në

tregun vendas apo ndërkombëtar. Forcat që lëvizin tregun dhe që duhen menaxhuar janë, furnitorët, klientët, konkurrentët direktë, hyrësat potencialë dhe prodhuesit e produkteve zëvendësuese. Këto elementë duhen patur parasysh në çdo moment dhe nga ana e qeverive.

Shqipëria dhe Kosova janë importuese neto produktesh importi dhe funksionojnë si tregje te ndara, ku secila ka firmat e veta të importit. Këto firma u shesin popullsisë përkatëse të dy tregjeve të ndryshme në dy legjislacione të ndryshëm. Çmimi që aplikohet është më i lartë se në rastin kur kontraktori importues do të ishte i vetëm dhe do të kish mundësinë t'i shiste një tregu prej pothuaj 7 milion banorësh, në vend të mesatarisht 3 milion banorësh që është sot. Fakti që kjo sot nuk ndodh do të thotë që kostot e importimit dhe shitjes së mallit në të gjithë tregun Shqiptar, nga e njëjta firmë, me bazë në Kosovë apo Shqipëri, janë të larta. Për të operuar në dy vende të ndryshme duhet të kesh dy firma të ndryshme, me kosto administrative, tatimore etj shtesë, për të evituar kostot doganale. Duke lënë mënjane për momentin diferencat në kostot tatimore, nëse nuk do të egzistonin kostot doganore atëherë firmat në të dy vendet do të mund të konkurronin tanimë për shitjen në një treg prej 7 milion banorësh. Kompetitiviteti do të bente të mundur që, firmat me kosto më të ulëta, do të nxirrnin nga tregu ato më pak efiçente. Psh. firmat që kanë kosto më të ulëta të transportit për mallra importi të caktuara do të udhëheqin tregun përkatës. Për ta kuptuar më mirë; teorikisht,firmat Shqiptare të importit të mallrave prej porteve të Adriatikutdo të ishin të avantazuara, ndërsa firmat e Kosovës do të ishin në avantazh me firmat Shqiptare për mallra importi prej Serbisë etj.

Mundësia e një tregu unik do të bënte të mundur kontraktimin me një fuqi më të madhe me furnitorin duke pasur si rezultat çmime më të ulëta për konsumatorin dhe fitime me të larta për firmat importuese si rrjedhojë e rritjes së bazës konsumatore, në një treg prej 7 milion banorësh.

Por, rritja e bazës konsumatore nxit edhe shtysën për të prodhuar mallrat në vend. Kjo pasi në një treg me 7 milion banorë ka me shumë gjasa që të ulen kostot për njësi të prodhimit në një masë të tillë që të shndërrojnë në fitimprurëse bizneset prodhuese. Mundësia më e mirë për këtë do të kish qënë filtrimi i mallrave të para të shportës së importit dhe inçentivimi i prodhimit në vend të tyre me efekte pozitive për punësimin. (duke konsideruar Shqipërinë me Kosovën bashkarisht).

Pra, nuk ka asnjë dyshim që bashkimi i tregjeve është i vlefshëm për të dy vendet. Problemi qëndron se çfarë duhet bërë për të eliminuar pengesat egzistente midis sistemeve ekonomike të Shqipërisë dhe Kosovës. Përpara se të vazhdojmë me sqarimin e kësaj pike le t'i referohemi dhe njëherë përcaktimit të tregut: Bashkësia e relacioneve ndërvepruese shkëmbyese midis aktorëve të ofertës me ata të kërkesës realizuar nën ombrellën e një kuadri të caktuar ligjor. Relacionet ndërvepruese në një treg të veçantë karakterizohen nga kostot më të ulëta që ato prezantojnë me njëra tjetrën brenda tregut, në krahasim me tregje të tjerë të jashtëm. Pra, brenda tregut kostot e relacionimit duhet të jenë më të ulëta. Për rëndësinë që merr unifikimi ligjor i të drejtës private (civile) e kemi cikur më sipër si një kusht i paevitueshëm dhe i domosdoshëm për egzistencën fillestare të tregut. Më pas sqaruar rëndësinë e eliminimit të barrierave doganore.

Por krijimi i një tregu të përbashkët kërkon dhe plotësimin e disa kërkesave të tjera. Brenda tregut është e rëndësishme që aktorët tu nënshtrohen të njëjtave kushte. Nëse aktorët u nënshtrohen dy sistemeve të ndryshëm fiskalë atëherë nuk mund të flasim për treg unik, por për tregje të ndryshëm, dhe pamë më sipër që tregje të ndara Shqipëri – Kosovë janë më të dobëta në lidhje me tregjet e furnizimit dhe pengojnë zhvillimin e prodhimit vendas për shkak të mungesës së ekonomisë së shkallës.

Pra një pikë tjetër e rëndësishme themelore është unifikimi fiskal i të dy vendeve. Kjo është, besoj, pika më problematike, ajo nga e cila qeveritë e të dy vendeve e kanë më të vështirë të ndahen. Por nëse iu referohemi sinjaleve të fundit, ku nga qeveritarë të ndryshëm të vendeve të CEFTA-s është folur për një Federatë Ballkanike, atëherë humbja e pavarësisë fiskale në favor të një entiteti që mund të krijohet *ad hoc* është e domosdoshme. Arsyet janë të njëjtat me sa kemi cikur më sipër: Nevoja për krijimin e tregut unik të përbashkët, që do të lejojë përballjen dinjitoze të Shqipëri + Kosovë në skenën kompetitive Ballkanike. Futja në një federatë utopike ballkanike me sisteme të ndara mund të rezultojë problematike për Shqipërinë dhe Kosovën, pasi të ndara, si aktorë të ndryshëm ekonomikë nuk mund të shfrytëzojnë të plotë potencialin që do të mund të ofronte krijimi i një Entitetit të ri në hapësirën Shqiptare. Ideja është që në një rast hipotetik të krijimit të hapësirës ballkanike Shqipëri + Kosovë mund të marrin rolin e Udheheqësit (leader) vetëm po të kenë krijuar tregun unik. (Duke konsideruar burimet natyrore dhe pozitën gjeografike roli i liderit në ballkan do të vinte vetvetiu)

Rol të udhëheqësit që, jo vetëm nuk e kemi por në tregjet tona po të merren ekstraktet e regjistrimit të ndërmarrjeve do të shohim se kush realisht i kontrollon ekonomitë tona. Gjëja më normale do të jetë që këta aktorë importi (të huaj të hapësirës Sllave) dominantë në tregjet tona, do të mbrohen me forcë, por nuk do ta kenë të mundur të ekzistojnë dhe të ushtrojne presion në një treg të përbashkët të Shqipërisë etnike prej 7 milion banorësh.

Por, krijimi i një Entiteti të ri ekonomik juridik që do të marrë kompetenca ligjore Shqipërisë dhe Kosovës, është i vështirë duke konsideruar kontekstet e ndryshme ekonomike në Shqipëri dhe Kosovë për këto arsye:

1. Kosova nuk prezanton një borxh të lartë publik, ndërsa Shqipëria po;
2. Kosova e ka tatimin mbi fitimin 10% ndërsa Shqipëria 15%.
3. Do kontrolloar se sa është T.V.SH (VAT) në Kosovë).
4. Monitorimi Ndërkombëtar në Kosovë dhe presioni i FMN-së në Shqipëri.

Këto pengesa na bën të kuptojmë që do të ketë dhe kosto për unifikimin e tregut. Me borxhin e lartë publik që prezanton Shqipëria, e vetmja mundësi është që Kosova t'i përshtatet normave fiskale të Shqipërisë. Kjo është një kosto për sa i përket kompetitivitetit fiskal, por nga ana tjetër tregu prej 7 milionësh do të ketë më shumë përfitime që do të mbulojnë këto kosto.

Ky Entitet i Ri duhet të jetë hapi i parë, përpara krijimit të çfarëdo krijimi federativ rajonal, me qëllim shfrytëzimin e potencialeve dhe rezurseve që vendet tona gëzojnë. (Me qëllim që rezurset tona t'i përdorim si Forcë dhe mos të jenë llokma të thjeshta të firmave të huaja.)

Në përbërje të këtij Entiteti duhet të përfshihen specialistë elitarë nga shkenca, ekonomia, menaxhmenti dhe jurisprudenca e të dyja vendeve.

Duke vazhduar me definicionin e tregut, një treg mund të jetë i veçantë, unik, nëse kostot e shkëmbimeve brenda tij janë më të ulëta se tregjet kufitare. Për këtë duhen eliminuar të gjitha kostot shtesë...

Qarkullimi i dy monedhave të ndryshme në të dy vendet Shqipëri dhe Kosovë, përcakton një kosto me të lartë dhe një risk valutë, në shkëmbimet midis tyre. Kjo kosto, ky risk, do të mund të eliminohej me futjen e një monedhe të përbashkët midis dy vendeve. Kjo monedhë mund të jetë leku ose një tjetër e përbashkët për shkëmbimet reciproke. Këtu, do të mund t'i drejtohem Bankës së Shqipërisë si një autoritet i pavarur që mund të ushtrjë të drejtën e sinjoralitetit, njëkohësisht dhe qeverive përkatëse. Mjafton që qeveria e Kosovës të pranojë dhe qarkullimin e lekut ose të monedhës së përbashkët brenda territorit të saj, në pagesat qeveritare dhe pagat në vend, duke eliminuar në këtë mënyrë, pamundësinë e Bankës Qendrore të Kosovës.

Mundet, gjithashtu, që kjo detyrë t'i ngarkohet një entiteti tjetër qendror monetar të përbashkët.

Tregu i unifikuar Shqipëri – Kosovë është një mundësi e artë për tu incentivuar dhe shfrytëzuar, për rritjen e sigurisë ekonomike dhe rolit rajonal të entitetit shqiptar rajonal.

Pikat e domosdoshme, ku duhet të mbështet një unifikim i tillë i tregjeve janë:

1. Unifikimi doganal.
2. Unifikimi Fiskal
 - Krijimi i Entiteteve ekonomiko – juridike mbi-kombëtare.
1. Krijimi i monedhës së përbashkët nëpërmjet Bankës së Shqipërisë ose krijimit të një Entiteti Monetar të përbashkët.
 - Mjafton që një nga këto pika mos të plotësohet dhe nuk mund të flasim për treg unik, por treg konkurrencial mes veti.

Dhe pika e fundit e më e rëndësishme është ndërgjegjësimi për ekzistencën e oportunitetit të madh që sjell një treg i unifikuar.

Nëse këto nuk verifikohen, jo që nuk do të mund të flasim për treg unik, por nën ndikimin e lobeve furnitore importuese, do ta kemi gjithnjë e më të vështirë për të folur për të njëjtin komb në Shqipëri dhe Kosovë.

Nëse një komb karakterizohet nga Kultura dhe gjuha e përbashkët dhe nëse kultura ndikohet nga realiteti i shkëmbimeve dhe konteksti i përditshëm, atëherë mungesa e shkëmbimeve ekonomike, kulturore mes veti, do të shkaktojë një ndarje dhe më të thellë sesa aktualja e do të jete vështirë të vazhdojmë të flasim për një komb....

Në fund, kompleksiteti i këtyre ideve është shumë i lartë, por vështirësia më e madhe është politike: do të pranojnë qeveritarët tanë të humbasin një pjesë të pavarësisë institucionale, në favor të një entiteti ekonomik mbarëkombëtar? Kompleksiteti i dytë lidhet me profesionalizmin: Do të jenë të aftë qeveritarët tanë të paraqesin në negociatat me ndërkombëtarët koston e lartë politike ekonomike që dy vendet tona paguajnë duke qëndruar të ndara?

Profesionalizëm do të thotë dhe meritokraci, dhe kjo duhet të jetë objektivi i përbashkët i qeverive që punojnë për vendin. Pa meritokraci, nuk ka profesionalizëm, nuk ka mbrojtje interesash madhore për ekonominë e të dy vendeve.

14. Zhvillimi i bankave komunitare. Miliarda euro të depozituesve shqiptarë sot janë të bllokuar në sistemin bankar duke paralizuar investimet. Shteti shqiptar vazhdon të indebitohet në valutë të huaj pavarishtë pasurive shqiptare të ngrira nëpër banka dhe pavarishtë monetares që disponon ndryshe nga vende të tjera që e kanë humbur. Kjo situatë duhet të ndryshojë duke ristrukturuar sektorin bankar, duke e shkëputur nga lidhjet perverse me pushtetin, duke ulur riskun e kredihënies me ndërmjetësimin e shtetit po rmbi të gjitha duke nxitur krijimin e bankave komunitare për të mundësuar aksesin në kreditim të sipërmarrësve shqiptarë si një e drejtë kushtetuese e pamohueshme.

15. Krijimi i bursës. Errësira në politikbërje i ka rrënjët thellë në errësirën e parave në qarkullim. Nëse duam të shkulum korrupsionin dhe të ndërtojmë demokracinë reale duhet të bëjmë urgjentisht transparencën e qarkullimit të parave në këtë vend. Bursa nuk është thjesht një vend shitblerjesh të titujve financiarë. Ajo është projekcioni i një ekonomie që zhvillohet në dritën e diellit. Ajo nënkupton që bota e biznesit realizon një vlerësim të vërtetë të gjithë asetëve dhe veprimtarive të tyre pa iu fshehur as shtetit dhe as publikut. Po këtu politikanët vijnë për të krijuar pasuri duke vjedhur dhe duke favorizuar binzeset e familjeve dhe duke rrënuar konkurrencën e lirë në treg. Në të gjitha vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, me një të kaluar të ngjashme me Shqipërinë, shteti ishte promotori dhe mbështetësi kryesor i krijimit të bursave. Por, në Shqipëri shteti në duar të mafiozëve blu e rozë nuk ndoqi këtë rrugë. Askush nuk ishte i interesuar për të bërë transparencën e pasurive në këtë vend. Nuk është rastësi që edhe SOT askush nuk flet për ngritjen e një Burse Normale dhe Funktionale. Pavarësisht mbështetjes financiare nga ana e donatorëve, qeveritë shqiptare nuk zhvilluan kurrë tregun kapitaleve nepermjet: Listimit të ndërmarrjeve shtetërore në burse – BT nuk u përfshi në procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore, ashtu siç ka ndodhur në të gjitha vendet e rajonit dhe vendet e Evropës Lindore, që kanë ngjashmëri me Shqipërinë. Qeveria shqiptare asnjëherë nuk organizoi një ofertë publike fillestare (IPO) për ndërmarrjet në pronësi shtetërore, cka do të

kishte sjellë listimin dhe kuotimin (tregtimin) e aksioneve të këtyre kompanive në BT. Shkatërrimi i impiantit tonë industrial dhe privatizimi në duart e mafiozëve, ka çuar në gjendjen e tanishme të një katastrofe ekonomike të ndërmarrjeve prodhuese në vend. Përsa i përket Historisë së krijimit të Pseudo Bursës shqiptare, duhet të kujtojmë se fillimi i Ekonomisë së tregut të lirë, solli edhe nevojën për krijimin e tregut të kapitaleve dhe hartimin e kuadrit të nevojshëm ligjor, cka u realizua me mbështetjen dhe asistencën teknike të konsulentëve të huaj si USAID dhe Fondi Britanik “Knoë-Hoë”. Gjatë kësaj kohe, në vitin 1995 u miratua ligji “Mbi Fondet e Investimeve në Bono Privatizimi”, i cili rregullonte marrëdhëniet ligjore vetëm për fondet e investimeve në bono privatizimi. Gjithashtu, u krijua Qendra e Regjistrimit të Aksioneve (QRA), e cila regjistron në formë elektronike të gjitha të dhënat e nevojshme mbi ndryshimin e pronësisë në kompanitë private. Një vit më vonë, parlamenti shqiptar miratoi ligjin nr. 8080, dt. 01.03.1996, “Për Letrat me Vlere”, duke i hapur rrugën krijimit të Komisionit të Letrave me Vlere (KLV) në prill 1996 dhe Bursës së Tiranës (BT) në maj 1996, pranë Bankës Qendrore. Në vitin 2004, konsulenti i huaj financiar GMA Capital Market Ltd., në kuadër të një projekti të financuar nga Banka otore për Asistencën Teknike për Ngritjen e Institucioneve në sistemin Financiar (FSIBTA), përgatiti një raport të detajuar mbi zhvillimin e tregut të kapitaleve në Shqipëri. Nga 1 korriku 2002 Bursa e Tiranës u shkëput fizikisht nga ambientet e Bankës së Shqipërisë për të vazhduar aktivitetin e saj si institucion

i pavarur dhe prej datës 5 nëntor 2002, mori liçencën paraprake për të vepruar si treg letrash me vlerë. Në një kohë kur qeveritë i ngrënë Bursat me njerzit (ekonomistët) më të zotë si një domosdoshmëri, në Shqipëri i paskan dhënë liçencë, atij institucioni aq të rëndësishëm, që mban në gjirin e tij gjith prodhimin bruto kombëtar, atij institucioni që ka të egjistruar gjith asetet, aktivitetet, prodhimet e gjithë firmave apo individëve, duke menduar sikur në Bursë marrin pjesë ca individë, ca firma e shesin e blejnë ndërmarrjet e tyre kambistët ambulantë. “Ekzistojne” institucione financiare, te cilat ofrojnë shërbime ndërmjetesimi (brokerimi). Kështu, përveç bursës së vetme në treg, KLV ka licencuar edhe Qendrën e Regjistrimit të Aksioneve, e cila bën të mundur pastrimin dhe rregullimin e transaksioneve në letra me vlerë të pronësive; shtëpitë e brokerimit, te cilat mund të realizojnë ndonjë ofertë publike apo tregtim të letrave me vlerë në tregun sekondar. Shitblerja e bonove të thesarit ka qenë aktiviteti fillestar i Bursës së Tiranës. Dhe ky operacion bëhet larg transparencës në favor vetëm të këtyre vemjeve që kuptuan se mund të vidhnin dhe prej kesaj. Ndryshe nga eksperiencat e vendeve perëndimore me një ekonomi të konsoliduar prej kohësh dhe duke marrë parasysh eksperiencat relativisht të suksesshme vendeve të Evropës Lindore,

Shteti shqiptar duhet të ndërmarrë iniciativa ligjore për të **detyruar** listimin në BT të kompanive, të cilat arrijnë një nivel

kapitali të caktuar. Gjithashtu, Qeveria mund të nxisë zhvillimin e tregut të kapitaleve nëpërmjet ofrimit të incentivave fiskale për kompanite e listuara në BT si p.sh., përjashtim nga taksat/reduktim taksash për një periudhë kohore të caktuar. Të gjitha këto incentiva do të ndihmonin shtetin shqiptar në reduktimin e shkallës së lartë të informalitetit në ekonomi, si dhe do të bënin të mundur që biznesi vendas të ishte më familjar me një alternative financimi të re dhe relativisht më pak të kushtueshme se financimi nëpërmjet sektorit bankar. Vetëm në këtë mënyrë ekonomia shqiptare do vihej në shinat e një ekonomie transparente, të pastër, me vizion evropian e aftë të ngrihej dhe të konkurrenente me simotrat e saja në rajon dhe më gjerë.

16. Bujqësia dhe Prona. Zgjidhja e problemit të pronës. Kaosi i organizuar mbi pronën, dhjetëra ligje dhe ente administrative, është antikombëtar dhe mban peng zhvillimin e ekonomisë shqiptare. Pushtetarë, politikanë, gjyqtarë dhe klientë të pushtetit përfitojnë përditë nga kjo situatë duke përvetësuar prona të pronarëve të ligjshëm ose duke zvarritur çështje pafundësisht.

Do të ndiqet shembulli gjerman dhe me një ligj patriotik, do vendoset një afat brenda të cilit të gjithë do të depozitojnë pretendimet e tyre dhe brenda një afati dy vjeçar të gjitha problemet e pronës të zgjidhura nuk do të hapen më. Ky proces do të lehtësohet nga shteti me krijimin e seksioneve të veçanta

nëpër gjykata me ndihmën e një trupe prej 500 juristëve dhe avokaturës së shtetit.

Dalja nga bujqësia e natyrës drejt një bujqësie të tregut kërkon reforma të thella:

1. Zgjidhjen e problemit të pronës brenda dy viteve. Do vihet një afat brenda së cilës të gjitha pretendimet dhe zgjidhjet e tyre do përfundojnë me mbështetjen financiare dhe llogjistike të shtetit (magjistratë, këshilltarë dhe avoketër ekstra).
2. Kompensimi i plotë i pronarëve të pronës me fonde shtesë të siguruar nga konfiskimet e pasurive kriminale dhe ato pushtetare.
3. Politika për deparcelizimin e pronës, subvencionuese për bujqësinë dhe blegtorinë.
4. Krijimin e një industrie bujqësore.
5. Krijimi i një banke kombëtare bujqësore.
6. Krijimi i një rrjeti grumbullimi, shërbimi dhe burse ushqimor.
7. Krijimi i zinxhirit të agronomëve dhe veterinerëve në vend.
8. Azerimi i taksave për prodhimet ushqimore.
9. Mbrojtja e prodhimit vendas ndaj atyre të importit.

17. Gjenocidi enverist. Kasta postkomuniste me retorikën e saj boshe eklipsoi, relativizoi dhe rehabilitoi gjenocidin mbi shqiptarët nga diktatura më e egër në Europë. ShqipON është i vendosur të hapë dosjet e regjimit dhe të "shtrydhë" qelbin që

infektoi demokracinë shqiptare duke hedhur dritë mbi gjithçka dhe këdo. Kostoja më e madhe është heshtja dhe harresa. Gjenocidi do të mësohet nëpër shkolla si lëndë e veçantë dhe do ngrihen muze dhe memoriale për të kujtuar popullin shqiptar që kjo faqe mos të përsërite më kurrë. Ish të persekutuarit të përçarë nga kasta, do dëmshpërmbelen për vuajtjet e tyre dhe për kontributin që dhanë për ndërtimin e veprave publike përgjatë 45 viteve.

18. Edukimi dhe arsimi. Zhvillimi i një shoqërie moderne në erën e informacionit dhe inovacionit, kërkon ngritjen e një sistemi edukativ dhe arsimor në lartësinë e sfidave globale. Do promovohen vlerat e edukimit në çdo sektor të arsimit shqiptar me konkurse mes shkollave dhe mbështetjes financiare për nxënësit dhe meësuesit më të dalluar për cilësi. është e rëndësishme qoftë për krijimin e një shoqërie të shëndoshë, ashtu dhe për funksionimin e demokracisë si një sistem që kërkon pjesëmarrje të një qytetari të informuar, por dhe një kusht i domosdoshëm në një ekonomi konkurrenente që kërkon operatorë të specializuar. Pra, ç ilësia e arsimit është një investim strategjik për demokratizimin dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Ajo çka ndodhur në Shqipëri këto 25 vite është krejt e kundërta, duke rrënuar dhe atë sistem arsimor që trashëguam. Sot statistikat

na rëndisin në vendet afrikane për edukimin universitat dhe parauiversitat. Kjo ka ardhur për disa faktorë:

- a. Zëvendësimi i meritokracisë me injorancën klienteliste
- b. Militantizmi partiak që instrumentalizon strukturat për mbajtjen dhe konsolidimin e pushtetit
- c. Mungesa e politikave mbështetëse për stafet pedagogjike.
- d. Korrupsionit kapilar të stafeve pedagogjike dhe mungesa e llogaridhënies
- e. Mungesa e transparencës në proceset didaktike.

shqipON mbledhi mijëra firma nga studentët në të gjitha universitetet shqiptare mbi **“Dekalogun e studentit”**.

1. Off: Drejtuesit aktualë, përgjegjësit direktë të katastrofës universitare! - ON: Zgjedhjes së organeve drejtuese dhe administrative, direkt nga të gjithë studentët në një Election Day!
2. Off: Funkionarët partiakë dhe militantët nga Universiteti Publik! ON: Akademikë të vërtetë nga Universitetet Perëndimore dhe ato vendase, një një konkurs gjithpërfshirës dhe transparent on line!
3. Off: Dorëzimit të Universitetit publik zotërve të parasë - ON: Respektimit të Kushtetutës dhe 3fishim i buxhetit për arsimin.
4. Off: Errësirës së jetës universitare - ON: Transapercncës së plotë mbi cv, pasuritë, lidhjet familare, aktivitetit partiak të stafit pedagogjik; publikim i buxhetit, listës së pagesave që kryhen në Universitet!

5. Off: Arrogancës së Sekretarive dhe administratës universitare! - ON: Realizimi on line i gjithë shërbimeve për studentin!
6. Off: Rritjes së tarifave për studentin! - ON: Ngrirjes së tarifave të studimit dhe krijim i një politike kombëtare bursash!
7. Off: Getizimit të ambienteve Universitare! -ON: Krijimit të godinave, bibliotekave dhe kampuseve të reja. Çlirimi i QS nga baronët e makiatos!
8. Off: Numrit të pakët të docentëve! - ON: Indeksimin me parametra evropianë të raportit Docent/student!
9. Off: Abuzimit në vlerësimet e studentëve! - ON: Krijimit të një zyre qendrore për standardizimin e metodës transparente për çdo provim me një vlerësim objektiv dhe të menjëherëshëm falë teknologjisë optike! Leksione on streaming, për të kuptuar të gjithë cilësinë dhe devotshmërinë e çdo docenti në procesin mësimor!
10. Off: Fabrikave të diplomave! - ON: Kushtëzimin e çdo diplome të marrë në një provim shtetëror transparent dhe on line!

19. Shëndetësia. E drejta e shëndetit dhe një jete cilësore është një e drejtë themelore dhe si e tillë duhet tu grantohet të gjithë qytetarëve në nevojë pavarisht kushteve ekonomike. Në qendër të sistemit shëndetësor do të jetë pacienti dhe jo klienti. Kontributet financiare publike dhe private, nuk do përfundojnë

më drejt mjekëve dhe rrjetit pervers të krijuar këto 25 vite, por do të futen në sistem për ti shërbyer të gjithë qytetarëve. Figura e mjekut do rikthehet të jetë dinjitoze pranë qytetarëve në nevojë. Cilësia e shërbimit nuk do ti lihet në dorë “dashamirësisë” së mjekut por do të garantohet nga një transparencë totale dhe llogaridhënie shumë nivelëshe.

Kurse politikat shëndetësore do i largohen modelit korruputiv klientelist, partiak e oligarkik dhe do orientohen paraekzaminimit falas dhe periodik. Eksperiencat më të mira perëndimore kërkojnë të shkojmë drejt mirëqënies jo vetëm ekonomike por dhe shpirtërore të popujve si mënyra më e mirë për të parandaluar sëmundjet dhe epidemitë. Ndërtimi i qyteteve, hapësirave, kushtet dhe siguria në punë, krijojnë sensin e lumturisë së njeriut si ilaçi më i mirë ndaj stresit dhe ndjenjës së konkurrencës në çdo cep të jetës.

Këto jenë disa prej propozimeve:

1. Forcimi i legjislacionit penal dhe disiplinor ndaj abuzimit të mjekëve dhe operatorëve të tjerë me shëndetin e njeriut.
2. Ndalimi i dypunësimit të mjekëve në sektorin publik dhe privat. Përvetësimi i makinerive, barnave etj, “trafikimi” i pacientëve nëpër qendra private, lidhjet perverse me operatorët privatë në sektor realizohen falë këtij privilegji. Monopolizimi i shërbimeve, penalizmi i mjekëve të rinj është gjithashtu pasojë e kësaj mendësie klienteliste.

3. Drejtori i përgjithshëm të zgjidhet me votimin e të gjithë profesionistëve të strukture spitalore (mjekë, infermierë, fizioterapistë, etj)
4. Primari të zgjidhet me votimin e gjithë stafit të pavionit.
5. Drejtori mjekësor i pavionit të zgjidhet nga mjekët dhe infermierët.
6. Kartelat e pacientëve të jete on-line me firmë digitale dhe me kod personal.
7. Të ketë një vlerësim multidisiplinor të pacientit(mjekësor, infermieristik, etj) me vlerësimin e rrishtit.
8. Krijimin real të DRG(diagnosis- related group) si mënyra më e mirë për ti dhën pazientit të duhur shërbimin e duhur.
9. Transparenca. është e domosdoshme ngritja dhe forcimi i një sistemi shëndetësor transparent të bazuar në meritokraci dhe llogaridhënie:
10. Të ardhurat dhe shpenzimet e spitaleve online
11. Cv e mjekëve dhe procedura e rekrutimit të jenë të aksesueshme online nga të gjithë qytetarët
12. Rezultatet e vizitave të jenë të shkruara qartë dhe të regjistruara elektronikisht.
13. Kartelat klinike të pacienteve të mbildhen në një arkiv elektronik kombëtar, dmth cilido mjek duhet të jetë në gjendje të ketë akses në kronologjinë mjekësore të pacientit.
14. Recetat të plotësohen me kompjuter dhe të mbildhen në kartelën klinike të pacientit. Në receta të tregohet ekskluzivisht principi aktiv dhe jo marka.

15. Instrumentat dhe mjetet spitalore të jenë gjithmonë të përdorshme dhe përndjekje penale për ata që, për interesa personale, dërgojnë pacientët në struktura private.
16. Shërbime bazë efikase të garantuara për të gjithë shtresat më në nevojë të popullsisë.
17. Shërbim urgjence efikas, që përfshin dhe rinovimin e mjeteve dhe krijimin e garantimin e korsive preferenciale për shërbimin e urgjencës.
18. Ndalimi i dypunësimit në publik dhe në privat. Shqipëria nuk është sot gati të garantojë që të punuarit e një mjeku ne spital privat të mos influencojë punën e tij në strukturat spitalore publike.
19. Farmacitë të publikojnë on line bilancet e tyre si dhe të publikojnë, të paktën cdo dy muaj, cmimet e barnave që ata tregtojnë.
20. Të ndalohet shitja në Shqipëri të barnave që nuk lejohen të tregtohen në tregun e BE-së.
21. Ngritjen e një strukture eficiente të shërbimit të urgjencës si garanci e shpetimit të jetësdhe vlerësimit në loco të komplikancave.
22. Formimit të equipe multifunksional për trajtimin e rastere të rënda dhe jo më konsulta.
23. Vepra penale qe parashikojne domosdoshmerisht burg dhe jo thjesht gjobë, dënime që heqin liçencën e mjekut përgjithmonë në rastet: për marrje rrushfeti apo forma të ngashme.

24. Të ketë vetëmenaxhim të buxhetit spitalor për të rritur përgjegjësin dhe eficientë e shërbimit.
 25. Te hapen qendra spitalore ne cdo qytet si dhe te hapen qendra shendetesore neper rrethe dhe fshatra.
 26. Krijimi në mënyrë kapilare në vend të shërbimeve spitalore për mos të pasur Tiranën si e vetmja pikë.
 27. Të hapet qendra e statistikës spitalore për të monitoruar shpezimet dhe sëmundjen në ecurin e tyre.
 28. Të krijohet nje grup kontrolli nga ministria i cili të jetë i përberë me profesionistë të fushës së mjekësisë për kontrollin e barnave në spital, të cilësisë së shërbimit, profesionalizmit dhe të ket vendimëarrje në zbatim ligji. Ashtu sic vëndet perëndimore kanë (italia N.A.S.)
 29. Të krijohen grupe ekspertësh të trajnuar në kontrollin e bujqësisë, mjedisit, farmaceutikës dhe bulmetit.
 30. Kredite të detyruara vjetore për të gjithë profesionistët shëndetësorë me kurse falas të ofruara nga Ministria e Shëndetësisë.
 31. Të furnizohen me materiale, me specialiste në fushën e mjekësisë, infermierisë, mamisë dhe të disiplinave te tjera mjekësore për të qënë sa më eficente dhe konkret në ndihmë dhe me paisjet më moderne në dispozicion te gjitha qendrat spitalore të 12 qarqeve, si dhe te rikëthehen në punë ambulancat nëpër fshatra dhe rimëkëmbia e shërbimit terciar.
- Respektimi i pikave të mësipërme do sillte një frymë të re pune dhe profesionalizmi duke na laguar nga kjo hije e zezë që ka

mbuluar shëndetësinë. Janë hapa të domosdoshëm për të rimarrë besimin e pacientit në garantimin e sigurisë dhe shëndetit të tij.

20. Qyteti. Qytetet duhet domosdoshmërisht të përshkohen nga një rrjet hapësirash për këmbësorë dhe nga ambiente social kulturore zbavitëse sepse izolimi në një qytet të betonizuar dhe pa hapësira publike çdon drejt shaktërrimti gradual të relacioneve humane. Në qytetet shqiptare ajo çka është cilësore është private dhe e kushtueshme. Shtëpi të bukura, lokale, dyqane, spektakle argëtuese dhe qendra tregtare. Dikur njerezit takoheshin në sheshe dhe parqe publike, tani i vetmi vendtakimi janë lokalet dhe qendrat tregtare ku njerezit nuk krijojnë dot ato marrëdhënie të hapura por shtyhen drejt konsumimit. Një shoqëri që prodhon njerëz gjithmonë e më të vetmuar dhe më të gatshëm që ta konsiderojnë blerjen si zgjidhjen e problemeve të tyre. Prandaj depresioni dhe ndjenja e përjashtimit kur këto mndësi rrallohen. Prandaj, S.O.S. synon rikonceptimin e qyteteve me dimensione humane:

A. Hapësira publike në shërbim të nevojave relacionale të qyteteve. Sheshe, parqe, kënde lojrash në çdo lagje nuk do jenë më luks por prioritare duke vendosur vetë qytetarët për ndërtimin e tyre në menaxhimn e buxheteve. Ambientet social kulturore janë nevojë për trupin shoqëror po aq të

rëndësishme sa shkollat apo spitalet sepse rrisin kohezionin dhe solidaritetin social për të ardhmen.

- B. Korsi biçikletash** në gjithë qytetin dhe jo segmentare. Vendet evropiane me përdorim të biçikletave përmirësuan jetën komunitare dhe rrjetin e relacioneve sociale. Subvencim shtetëror për nxitjen e përdorimit të këtyre mjeteve, duke parë dhe distancat e shkurtra që karakterizojnë qytetet shqiptare.
- C. Krijim i parkimeve publike nëntokësore**, që makinat mos të hekurizojnë dekorin e qyteteve shqiptare. Gjohat për parkim do pezullohen deri sa shteti të realizojë këtë detyrim të tijin dhe duke nxjerre qytetarin nga një kurth dhe detyrim që nuk mund ta respektoje dot.
- D. Krijimi i një transporti** publik dinjitoz dhe kapilar në të gjitha lagjet e qyteteve për të zhdukur stresin e trafikut dhe ndotjen kancerogjene për popullatën. Vetëm kështu transporti publik do përdoret nga të gjithë qytetarët dhe jo vetëm nga ata që ndihen të përjashtuar nga kostot e një lëvizjeje të shtrenjtë dhe aspak dinjitoze.
- E. Qendra sociale dhe kulturore** te vetëmenaxhuara nga të rinjtë dhe jo si sot nga pushteti. Promovimi i talenteve dhe aktiviteteve kulturore realizohet vetëm me krijimin e këtyre ambienteve publike në shërbim të rinjve. Pilotimi nga pushteti i të rinjve duhet të marrë fund, duke i lejuar vetë të rinjtë të

jenë kritikë ndaj të sotëm dhe kreativë në ndërtimin e një bote më të mirë.

F. Biblioteka në çdo lagje me një shërbim dinjitoz për të rikthyer kulturën e librit, leximit dhe dijes. Avancimi i debateve dhe mendimeve ndryshe. Sot bibliotekat janë zhdukur nga çdo qytet dhe qendra komunitare.

21. Krijimi i class action dhe formave të tjera për mbrojtjen e konsumatorit shqiptar ndaj vërshimit të mallrave në erën globale. Përgjegjësi penale dhe heqjen e liçencave për ata që rrezikojnë shëndetin e qytetarëve. Ekonomia jonë do jetë konkurrenciale nëse rikthehet virtuoze dhe hiqet dorë nga parazitizmi dhe shkeljet korruptive me pushtetin.

22. Mbrojtja e veçantë e artit, sportit dhe trashëgimisë kulturore. Humbja e vlerave është fatale për të ardhmen e vendit prandaj ky detyrim kushtetues nuk do i lihet vetëm aktorëve dhe televizioneve private por do të jetë nën kujdesin e shtetit. Mbështetja për kinematografinë dhe artin shqiptar për të rikrijuar vërtet plejadën e artistëve shqiptarë larg miklimit me pushtetin dhe sekserët e tij. Festalet e këngës apo të humorit nuk do të i lihen në dorë të spekulatorëve privatë por detyrë e shtetit.

23. Konstitucionalizimi i Medias. Media si pushteti i Katërt dhe ashtu si të gjithë format e pushtetit nuk mund të mos vihet në

shinat e kushtetutës. Në epokën e erës së informimit, roli i media është shumë delikat për shoqërnë, demokracinë dhe ekonominë e vendit. Do shkulum nga rrënjët lidhjet e medias me pushtetin dhe krimin duke e kthyer në shërbim të qytetarit.

Oligarkia mediatike do të çmontohet duke e hapur sistemin për të gjithë sipërmarrësit e fjalës së lirë.

1. Do të përfundojë sistemi dixhital tokësor, sot i bllokuar me porosi të disa mediave të veçanta që kanë zaputar sektorin.
2. Liçencat kombëtare do të rinovohen një hjerë në 5 vjet dhe jo për gjithë jetën në dëm të konkurrencës.
3. Do ndalohen konfliktet e interesit e bizneseve të tjera me median. Nuk do lejohen media televizive dhe të shkruara që nuk justifikojnë ekzistencën e tyre ekonomike, por mbahen për qëllime të tjera influencimi të vendimve publike.
4. Pronësia e mediave do të jetë në formë aksioniere në jo më pak se 10 aksionierë, në mënyrë që mos të kemi një përqendrim të këtij pushteti kaq delikat për fatet e vendit.
5. Do të krijohet Shërbimi Kombëtar i Gazetarëve, i vetë organizuar i cili do merret me liçencimin e gazetarëve si dhe përjashtimin përfundimtar të tyre nëse me dashje keqpërdorin pushtetin mediatik.
6. Kthimi i dinjitetit të televizionit shqiptar, që sot mbahet në gjendjen e mjeruar për llogari të mediave private dhe të

një pushteti klientelist. Drejtori i RTSh-së do të zgjidhet direkt nga qytetarët dhe jo nga partitë si sot.

24. Parashikimi dhe ashpërsimin tejet të fortë i veprave penale që kanë të bëjnë me korrupsionin, deklarimin e rremë dhe fshehjen e pasurisë së pushtetarëve, krimet ekonomike, abuzimet me barnat dhe ushqimet si dhe krimet elektorale.

25. Mbulimin falas të internetit mobile në çdo cep të Shqipërisë, pasi përbën një domosdoshmëri në shëprndarjen e informimit kudo dhe dhe përgatitjen e brezit të ri në erën dixhitale. Kostoja e këtij operacioni është minimale në krahasim me përfitimet që sjell dhe po zbatohet në shumë vende europiane.

26. Emigracioni shqiptar. Urgjenca dhe serioziteti i problemit të emigracionit kërkon një trajtim të githanshëm. Ne fakt për Shqipërinë, Emigracioni nuk është thjesht një problem, ai ka trajtën e një hemorragjie kombëtare. Jemi ndër vendet e para në botë për numrin e emigrantëve në përqindje. Shqipëria është ndarë në mënyrë dikotomike ku gjysma e saj ka braktisur vendin dhe nga sondazhet rinia synon ende ende ta braktisë atë. Por problemi nuk është vetëm sasior por dhe cilësor sepse ata që largohen janë dhe më të virtytshmit që nuk i dorëzohën realitetit banal shqiptar, por kërkojnë një botë më të mirë ku mund të punojnë dhe prosperojnë. Në fakt emigracioni dhe eksportimi i krahut të punës

ka balancuar deficitin tregtar dhe financiar të ekonomisë konsumiste të Shqipërisë për shumë kohë. Tani situata po fillon dhe po ndryshon. Deri dje merrej si e mirëqënë se emigrantët nuk kanë rrugë tjetër përveç kthimit. Pas shumë shpresave dhe pritshmërive, me të drejtë tek emigrantët por jo vetëm, po konsolidohet idea se Shqipëria ka pak gjasa të bëhet një vend normal, ku mund të investohet dhe të sigurohet një jetesë e qetë. Tani i duhet shtetit shqiptar që të zhvillojë politika jo vetëm të kthimit të emigrantëve në vend por dhe të tamponojë hemoragjinë aktuale. Duhet që praktikatat e shëmtuara të denigrimit të emigrantëve nga funksionarët publikë t'u jepet fund në mënyrë që ata mos ta ndejnë më veten të huaj në vendin e tyre. Ka ardhur koha që emigrantëve dhe diasporës shqiptare t'u dedikohen institucione përfaqësimi permanente ku ata të bëhen pjesë e vendimarrjes politike të vendit. Kontributi i tyre duhet të jetë dhe politik pasi ata janë përcjellës të praktikave më të mira perëndimore, kanë formuar sens të fortë kritik dhe nuk janë të prirur të pranojnë propagandën militantiste të partive dhe mund të sjellin format të reja të zhvillimit demokratik për Shqipërinë. Gjithashtu ka ardhur koha që qeveritë shqiptare të heqin dorë nga përqsja vampiriste që kanë për emigrantët dhe kursimet e tyre dhe të zhvillojnë politika fiskale që të mundësojnë investimet e tyre. Domsdoshmëri janë dhe politikat sociale, arsimore që të mundësojnë ripërshtatjen e emigrantëve, familjeve dhe fëmijëve të tyre në Shqipëri.

Për gjitha këto dhe më tepër ne propozojmë:

1. Krijimin e një **nëndhome përfaqësimi** në parlamentin shqiptar dedikuar emigrantëve dhe diasporës, e cila të konsultohet dhe të vendosë për ligjet më të rëndësishme të vendit! Nëse duam kontributin e tyre, duhet tju lejojmë një forum përfaqësimi dhe vendimarrjeje!
2. Realizimi pa vonesë e së **drejtës së votës** për emigrantët dhe diasporën shqiptare sipas praktikave të vendeve perëndimore. Si mund të mohojmë këtë të drejtë kaq shumë shqiptarëve dhe pjeseës më vitale të Shqipërisë? Kakofonia elektorale duhet tju lërë vendin nismave ligjore!
3. Krijimi i një Agjencie Kombëtare Diasporës dhe Emigrantëve dhe seksioneve të saja në vendet me prezencë të madhe të shqiptarëve! Krijimi i një Anagrafie me të dhëna të plota mbi vendodhjen e emigrantëve nëpr botë. Promovimin e personaliteteve shqiptare nëpr botë për të qenë këta ambasadoret natyrorë të Shqipërisë, për të shërbyer si ura komunikimi dhe për lidhjeet mes institucioneve shqiptare me ato ndërshetetërore dhe ndërkombetare.
4. Përshtatja e shkollës shqiptare në gjitha nivelet për të ndihmuar fëmijët e emigrantëve të arsimohen dhe të rehabilitohen në shoqërinë shqiptare.
5. Mostaksimi i çdo biznesi serioz për 5 vjet, që realizohet nga shqiptarët e ardhur në vendin e vet, dhe forma të tjera lehtësimi fiskal e doganor për këto investime.

6. Lehtësimi, dixhitalizimi dhe prodhimi on line, i gjithë dokumentave të nevojshme për emigrantët, familjet dhe pasuritë e tyre në Shqipëri.
7. Promovimin dhe inkurajimin e një rrjeti të përbashkët mes shoqatave shqiptare nëpër Botë me mjetë të ndryshme.
8. Detyrim për përfaqësitë shqiptare në botë për të bërë transparente aktivitetet dhe shërbimet e tyre; publikimi on line i CV-ve të stafit të tyre dhe projektet e tyre; Degjimi dhe regjistrimi on line i gjithë ankesave dhe propozimeve të emigrantëve për personat dhe shërbimet kryer nga ambasadat apo konsullatat!
9. Rikonceptimi i TVSH-së në funksion edhe të shqiptarëve jashtë atdheut. Hapja e seksioneve në vendet ku banojnë shqiptarët. Kurse serioze për mësimin e gjuhës dhe kulturës shqiptare npj TV dhe internetit.
10. Krijimi apo lejimi i një **kompanie ajrore low cost** (si ryan air) në mënyrë që emigrantëve tui lehtësohet financiarisht një kontakt më efikas dhe i shpejtë me Shqipërinë!

27. Vazhdim...